



**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 175, Datë 03.08.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “EDIANI” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHËNGJON 1” ME FUQI  
TË INSTALUAR 651 KW, HEC “SHËNGJON 2” ME FUQI TË INSTALUAR 356  
KW DHE HEC “SHËNGJON 3” ME FUQI TË INSTALUAR 341KW, ME FUQI  
TOTALE 1348 KW, ME VENDNDODHJE NË PËRROIN E KNELLËS, KOMUNA  
FAN, RRETHI MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Ediani” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shëngjon 1” me fuqi të instaluar 651 kW, HEC “Shëngjon 2” me fuqi të instaluar 356 kW dhe HEC “Shëngjon 3” me fuqi të instaluar 341kW, me fuqi totale 1348 kW, me vendodhje në përroin e Knellës, Komuna Fan, Rrethi Mirditë,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 134, datë 25.06.2018, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “Ediani” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shëngjon 1” me fuqi të instaluar 651 kW, HEC “Shëngjon 2” me fuqi të instaluar 356 kW dhe HEC “Shëngjon 3” me fuqi të instaluar 341kW, me fuqi totale 1348 kW, me vendodhje në përroin e Knellës, Komuna Fan, Rrethi Mirditë,

- Në vijim të këtij vendimi, ERE në zbatim të nenit 19 pika 2, të “*Rregullores së Organizimit dhe Procedurave të ERE-s*“ dhe nenit 10, pika 8 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*“, me shkresën nr. 55/41 Prot., datë 26.06.2018, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure.
- Në përfundim të afatit, të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*“, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Ediani” sh.p.k, për licencim në e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me korrespondencën zyrtare nr. 421/2 Prot., datë 06.07.2018, iu kërkuan subjektit sqarime dhe plotësime mbi aplikimin e tij.
- Subjekti “Ediani” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 421/3, datë 11.07.2018, ka përcjellë sqarimet dhe plotësimet lidhur me sa kërkuar.
- ERE në zbatim të nenit 38 të Ligjit “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*“, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet, edhe pse marrëveshja e koncensionit mund të jetë lidhur për një afat më të gjatë

Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të paraqitur, rezulton se aplikimi i shoqërisë “Ediani” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2,) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pika 4.1), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “Ediani” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shëngjon 1” me fuqi të instaluar 651 kW, HEC “Shëngjon 2” me fuqi të instaluar 356 kW dhe HEC “Shëngjon 3” me fuqi të instaluar 341 kW, me fuqi totale 1348 kW, me vendndodhje në përroin e Knellës, Komuna Fan, Rrethi Mirditë, për një afat 30 (tridhjetë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.